



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Nr. 12854/Prot
4

Lezhë, më 20.08.2025

**PROCESVERBAL PËR KONSULTIMIN PUBLIK PËR MIRATIMIN E PLANIT
LOKAL TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E
ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE 2025-2030**

NJËSIA ADMINISTRATIVE LEZHË DATË 20.08.2025

LEZHË

I mbajtur sot me datë 20.08.2025, konsultim publik për miratimin e "Planit Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2025–2030", në Njësinë Administrative Lezhë ", sipas njoftimit të publikuar në faqen WEB-it të Bashkisë Lezhë, në linkun si vijon:

<https://lezha.gov.al/njoftim-per-organizimin-e-degjeses-publike-ne-lidhje-me-miratimin-e-planit-lokal-te-veprimit-per-barazi-20-08-2025/>.

Takimi nis me falenderime për realizimin e këtij plani të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2025 – 2030. Ky plan është realizuar në bashkëpunim me organizatën “Drejtësi Sociale” me pjesëmarrjen e 38 individëve të të gjitha insititucioneve. Prezantimi i këtij plani shërben si udhërrëfyes në fushat kryesore si : Arsimi dhe trashëgimia kulturore, punësimi, mbrojtja sociale, strehimi dhe infrastruktura, shëndetësia dhe mundësitë e barabarta. Plani është i bazuar në Strategjinë Kombëtare 2021-2025..

Problematicat kryesore deri më tani janë në ndjekjen e arsimit të mesëm dhe të lartë që kërkon ndërhyrje, punësimin dhe aftësimin profesional të komunitetit. Strehimi është një tjetër problematikë e këtij komuniteti duke qënë se kushtet e tyre të jetesës vazhdojnë të jenë jo të përshtatshme. Një shqetësim tjetër ishte ai i mungesës së vaksinimit në kohë të fëmijëve, kjo për shkak të lëvizjes së tyre nga një vend në një tjetër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Rekomandime

Disa ndërhyrje nga komuniteti rom dhe egjiptianë diskutuan për shifrat e popullsisë sipas Censusit nuk rakordojnë me numrin e popullsisë në realitet. Z.Bujar Berisha tha që ky komunitet është më i lartë në numër dhe ka nevojë për rregjistrimin e tyre. Kjo problematikë sipas tij vjen nga mosndarja e saktë nga gjendja civile. Ndërhyrje u bë dhe nga Znj. A.Marku e cila kërkonte një sqarim rreth masave të ndërmarra ndaj fenomenit të braktisjes së shkollës. Referentja e takimit foli mbi masat e marra për braktisjen duke filluar nga bursat që jepen për nxitjen e të rinjve për ndjekjen e arsimit të mesëm si dhe kurset passhkollore që ndihmojnë fëmijët e këtij komuniteti.

Takimi u mbyll me falenderimin e pjesëmarrësve nga drejtoresha e Shërbimit Social Znj. M.Fetaj.

Procesverbali u mbajt nga Suada Nekaj.


Drejtuesja Marte Fetaj.

Sekretare e Këshillit Bashkiak Florida Çunaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

Dëgjesa publike për "Planin Lokal të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2025-2030", Bashkia Lezhë





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL

